Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 05 Nr. Br. 16957
Sh. U. 04 Data: Datum: 08/07/2025
Br. str. KAMENICË/A

Drejtoria Komunale e Arsimit

Nr.558, dt. 07.07.2025

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniverzitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligji për Arsimin dhe Afësimin Profesional Nr. 04/L-138, si dhe në Udhëzimin Administrativ të MASHT Nr. 22/2013, "Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës" dhe Kushtet dhe kriterët për regjistrim.

# DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT SHPALL

# KONKURS

## PËR REGJISTIRMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË(10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2025/26

### I. Shkolla e Mesme e Lartë Gjimanzi:

**Gjimanzi "Ismail Qemali" në Kamenicë për vitin shkollor 2025/26**

| Shkolla | Drejtimi | Nr. i paraleleve | Nr. i nxënësve | Vitet e shkollimit |
|---|---|---|---|---|
| Gjimnazi | Sh.natyrore | 2 | 64 | 3 |
| | Sh. shoqërore | 1 | 32 | 3 |
| **Gjitsejt Kamenicë** | | **3** | **96** | |

**ShMLM "Sejdi Kryeziu" në Rogaqicë për vitin shkollor 2025/26**

| Shkolla | Drejtimi | Nr. i paraleleve | Nr. i nxënësve | Vitet e shkollimit |
|---|---|---|---|---|
| Gjimnazi | Sh.natyrore | 1 | 32 | 3 |
| | Sh. shoqërore | 1 | 32 | 3 |
| **Gjitsejt Rogaqicë** | | **2** | **64** | |

II. IAAP "Andrea Durrsaku" Kamenicë

Numri i nxënësve sipas planifikimit për regjistrim në drejtime dhe profile për klasët e 10-ta për vitin shkollor 2025/26

| Numri Rendor | Emri i shkollës | Drejtimi | Profilet | Planifikimi për vitin e ri shkollor 2025/26 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nr. i paraleleve | Nr. i nxënësve |
| 1 | IAAP "Andrea Durrsaku" Kamenicë | Makineri, Prodhim dhe Ndërtimtari | Automekanik | 1 | 15 |
| | | | Metalpunues | 1 | 15 |
| | | | Instalues Elektrik | 1 | 15 |
| | | Tek. e informacionit dhe komunikimit | Teknik per dizajnim te mediave interaktive | 1 | 15 |
| | | Sherbime | Kuzhinier-DUAL | 1 | 15 |
| | | Ekonomi, administrate dhe juridik | Tregtar me pakice dhe shumice-DUAL | 1 | 15 |
| | **Gjithsej** | | | **6** | **90** |

III. Shkolla e Mesme e Larte Mikse "Sejdi Kryeziu" Rogaqicë

Numri I nxënësve sipas planifikimit për regjistrim në drejtime dhe profile për klasët e 10-ta për vitin shkollor 2025/26

| Numri Rendor | Emri I shkollës Shkolla e Mesme e Lartë Mikse "Sejdi Kryeziu" Rogaçicë | Drejtimi | Profilet | Planifikimi për vitin e ri shkollor 2025/26 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nr. I paraleleve | Nr. I nxënësve |
| 2 | Shkolla e Mesme e Lartë Mikse "Sejdi Kryeziu" Rogaqicë | Makineri, Prodhim dhe Ndërtimtari | Trafik Rrugor | 1 | 24 |
| | | Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit | Informatike | 1 | 24 |
| | | Ekonomi | Banka dhe Financa | 1 | 24 |
| | **Gjithsej** | | | 3 | 72 |

**1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e kandidatëve**

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazit dhe IAAP në vitin shkollor 2025/2026, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligushëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.
Nxënësit të cilët kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

**2. Dokumentet e nevojshme për konkurim**

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe IAAP, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Fletëparaqitjen ( e cila merret në shkollën në të cilën konkuron)
- Dëftesën origjinale për kryrjen e shkollës së mesme të ulët (6-9)
- Certifikatën e lindjes.

**3. Afati i paraqitjes së dokumenteve, vendi dhe shpallja e rezultateve**

Dorëzimi i dokumenteve për konkurs në gjimnaz dhe shkolla IAAP për vitin shkollor 2025/6, bëhet më datën 08, 09 dhe 10 korrik **2025,** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga **ora 8:00—16:00.**
Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën: **11.07.2025.** Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës: 11.07.2025.
Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka te drejte ankese brenda (2) dy dite pune, nga koha e shpalljes se rezultateve. Ankesa

parshtrohet në drejtorinë e shkollës.
Ankesat ne shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. **Kriteret e regjistrimit**

Nxënësit pë regjistrim në klasën e 10-të, duhet t'i plotësojë këto kritere:

- Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë
- Suksesi nga lëndët prioritare në test ( 20%) 20 pikë
- Numri i pikëve nga testi (40%) 40pikë

Nxënësi maksimalisht mund ti fitojë 100 pikë

**Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaz është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4.00** (së pari llogartet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat ( 6-9), pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

- Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaz është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.
- Llogaritjen e pikëve të suksesit bëhet nga komisionet përkatëse për regjistrimin dhe pranimin e nxënësëve në klasën dhjetë.

Udheheqes i Sektorit për Arsim

Visar Dermaku